


MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLTË



KORRIK 2021

UNIVERSITETI POLITENIK I TIRANËS | PLATFORMA AKADEMIA SH.P.K | CROSSPLAG L.L.C

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLTË

Page 1 | 4

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLTË

mes

Universiteti Politeknik i Tiranës

dhe

“Platforma Akademia” L.L.C / Crossplag L.L.C

I. Qëllimi i Memorandumit

1. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin dhe gatishmérinë për bashkëpunim të ndërsjelltë. Ky memorandum ka për qëllim të përcaktojë bashkëpunimin mes Universitetit Politeknik të Tiranës dhe Platformës Akademia Sh.P.K, Prishtinë në fushën e kontrollit antiplagiaturë për kandidatët e doktoraturës të Universitetit Politeknik të Tiranës. Platforma Akademia Sh.P.K përmes nën kompanisë së saj Crossplag L.L.C do mundësojë procesin e ndërveprimit, komunikimit dhe kontrollimit të dokumenteve për Universitetit Politeknik të Tiranës dhe kandidatëve të në nivelin e studimeve “Doktoraturë”.

II. Fusheveprimitaria

1. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit rregullohet procesi i kontrollimit të punimeve të doktoraturës për Universitetin Politeknik të Tiranës.
2. Përmes këtij memorandumi përcaktohet procesi i kontrollit antiplagiaturë nga Universitetit Politeknik të Tiranës dhe qasje kandidatëve të këtij universiteti.
3. Platforma Akademia Sh.P.K, zotohet të ofrojë sistemin antiplagiaturë përmes markës Crossplag.com në mënyrë që të mbështetet procesi i pagesave përmes kartelave individuale të kandidatëve.
4. Platforma Akademia Sh.P.K zotohet se brenda afatit prej 10 ditë pune nga nënshkrimi i këtij memorandumi nga të dy palët, të ofrojë qasje papagesë për Universitetit Politeknik të Tiranës. Kjo qasje nënkuption që Universitetit Politeknik të Tiranës ka qasje në llogarinë “Vlerësues” përmes së cilët kryhen aktivitetet si më poshtë:
 - a. Regjistrimin e kandidatëve të doktoraturës përmes formës së regjistrimit ku duhet ofruar të dhënat bazike mbi kandidatin si: Emri, Mbiemri, Adresa Elektronike dhe gjuhët për kontroll.
 - b. Të ketë qasje në dokumentet e ngarkuara nga studentët dhe të ketë privilegje të vlerësimit të këtyre dokumenteve.
 - c. Shkarkimi i raporteve për përdorim offline

- d. Shkarkimi i certifikatës së ngashmërisë
 - e. Qasja në statistika
5. Platforma Akademia Sh.P.K zotohet të mundësojë procesin e ngarkimit dhe pagesave individuale për kandidatët e doktoraturës me oferta preferenciale. Rrjedhimisht, çdo kandidat i ftuar nga Universitetit Politeknik të Tiranës ka funksionalitetet si në vijim:
- a. Pranon ftesën nga Universiteti
 - b. Aktivizon llogarinë
 - c. Kryen blerjen përmes ofertave:
 - i. Custom – 5,000 fjalë për 8.95€
 - ii. PHD Thesis – 99.99€
 - d. Marrjen e rezultateve pas kontrollit nga vlerësuesit e Universitetit.
6. Në anën tjetër, Universiteti Politeknik të Tiranës vlenë të theksohet se nuk do ketë asnje implikim finansiar si institucion dhe rrjedhimisht zotohet që të përdorë Platformën Akademia, respektivisht Crossplag.com që të ju mundësojë kandidatëve të doktoraturës të kryejn kontrollin antiplagiaturë.
7. Universiteti Politeknik i Tiranës zotohet se do të ofrojë listën e vlerësuesve (stafit akademik që do e përdorim platformën) në mënyrë që atyre të ju hapen llogaritë e vlerësimit. Gjithsesi, Platforma Akademia mbetet e hapur që bazuar në udhëzimet e menaxhmentit të Universitetit Politeknik të Tiranës të bëj deaktivizimin e llogarive të stafit akademik apo shtimin e përdoruesve të rinjë sipas nevojës.
8. Kohëzgjatja e këtij memorandumi është 12 muaj me mundësi vazhdimi sipas nevojës së Universitetit Politeknik të Tiranës.

III. Përdorimi i informatave dhe dokumentacioni

I. Palët pajtohen që çdo informacion, dokument apo të dhëna, të shkëmbbyera apo të pranuara sipas këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, do të përdoren vetëm për qëllime të lejuara dhe brenda përkufizimeve të përcaktuar me këtë dokument. Palët nuk do të shpërndajnë apo bëjnë publike asnje informacion, dokument apo të dhëna ndonjërs palë për qëllime tjera, jashtë përkufizimeve të përcaktuara me këtë Memorandum apo që mund të bien ndesh me fymën e këtij, pa aprovim paraprak të palës tjetër;

II. Palët do të përdorin dhe trajtojnë çdo informacion, dokument apo të dhëna si komunikim të ndërsjellët me besueshmëri të plotë;

VI. Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim në realizimin e këtij Memorandumi, do të zgjidhet në fryshtë e tolerancës, mirëkuptimit dhe në bazë të suazave të kodit moral.

VII. Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit, përpos nëse parashihet ndryshe me marrëveshje nga ana e palëve të përfshira në memorandum.

SHTOJCA E DOKUMENTEVE

Bashkëngjitur me këtë Memorandum janë edhe dokumentet përcjellëse si në vijim:

1. Oferta e aprovuar
2. Udhëzuesi i përdorimit për llojin e llogarisë "Vlerësues"
3. Udhëzuesi i përdorimit për llojin e llogarisë "Student"
4. Lista për informata rreth vlerësueve

PALËT NËNSHKRUUESE

Universiteti Politeknik i Tiranës

Prof. Dr. Andrea Maliqari
Rektor
Tiranë më 19.07.2021

Nënshkrimi dhe Vula



**Platforma Akademica Sh.P.K / Crossplag
L.L.C**

Besart Kunushevci
Drejtor Ekzekutiv
Tiranë më 19.07.2021

Nënshkrimi dhe Vula

